

Tiranë 11 Qershor 2026

Drejtuar: Këshilli i Lartë Gjyqësor

Për dijeni:

Gjykata e Lartë

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë

Gjykata administrative e Apelit

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të përgjithshëm, Tiranë

Gjykata administrative e Shkallës së Parë, Tiranë

Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave, Jan Braathu

Zyra e Këshillit të Europës, Tiranë

Lënda: Kërkesë për respektimin e detyrimeve ligjore për mbulimin mediatik audio-viziv të proceseve gjyqësore

I nderuar kryetar i Këshillit të Lartë gjyqësor,

Të nderuar anëtarë,

Po ju drejtohem për t'ju shprehur shqetësimin tonë për situatat e krijuara së fundmi lidhur me praninë e kamerave gjatë proceseve gjyqësore.

Që prej vitit 2023, KLGJ, ka miratuar “Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”. Neni 14, pika 7 parashikon se pjesa hyrëse e seancës *“është e rregjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim”*. Fakt është se ky përcaktim është injoruar haptazi deri tani, dhe u vu në zbatim vetëm pasi kohët e fundit, disa të pandehur, figura të rëndësishme publike, kërkuar praninë e kamerave.

Neni 13, pika 1, i Udhëzimit të KLGJ-së përcakton se *“seancat gjyqësore janë të hapura për publikun dhe median”*. Megjithatë ky parashikim, mbetet i kufizuar në praktikë.

Sipas udhëzimit, media është e detyruar të paraqesë 24 orë përpara çdo seance, kërkesën për praninë e saj me kamera. Kjo nënkupton automatikisht se gjyqtari duhet të jetë po ashtu i detyruar, ta vlerësojë atë çdo herë që ajo paraqitet, e të shprehet me vendim të arsyetuar për rrëzimin e saj (deri më tani çdo kërkesë është rrëzuar). Por në praktikë po hasemi me raste, kur refuzimi i referohet vendimeve të marra edhe disa muaj më parë.

Neni 2, pika 1, i Udhëzimit tuaj parashikon se *“Marrëdhënia e gjykatës me publikun dhe median bazohet në parimet e aksesit të barabartë në gjykata, karakterit publik të procesit gjyqësor, hapjes maksimale të veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit, si dhe prezumimit të pafajësisë”*.

Në balancën e këtyre parimeve, qartazi, ai i të drejtës së informimit, i sanksionuar në Kushtetutë, duket se renditet i fundit, nga trupat gjyqësore, pa asnjë përpjekje për të gjetur një ekuilibër të duhur me parimet e tjera. Në praktikë po ndeshemi, me referimin e cenimit të parimeve të tjera, për të penguar atë të së drejtës së informimit.

Parashikimi juaj në nenin 14, pika 8/b, për refuzimin e kërkesës “kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca”, po përdoret gjerësisht si shkas për moslejimin e pranisë së kamerave, ndonëse i njëjti nen, në pikën 6/b, i njeh të drejtën gjyqtarit “të lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesës së seancës”, pra ta zbatojë këtë të drejtë, kur të jetë rrada e dëshmisë së të pandehurit që nuk dëshiron të regjistrohet, dhe jo ndalimin e regjistrimit të të gjithë seancës. A nuk përbën ky rast, një cënim të të drejtave të palëve të tjera në gjykim që e kërkojnë regjistrimin?

Për më tepër neni 14, pika 8/b, përcakton shprehimisht se avokati dhe prokurori nuk mund të kundërshtojnë kërkesat për regjistrimin e seancës. E megjithatë jemi dëshmitarë të rasteve, kur edhe ata janë shprehur në seancë.

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së,

seancat gjyqësore publike, nuk mund të nënkuptojnë vetëm publikun në sallë. Përndryshe, ky nocion do të ishte automatikisht i kufizuar, qoftë dhe vetëm për shkak të kushteve fizike të mjedisit ku zhvillohet procesi. Mediat, janë ato që shërbejnë në këtë rast, që ky nocion të përfshijë publikun e gjerë të interesuar.

Aq më i rëndësishëm bëhet ky rol i mediave, kur asnjë prej gjykatave shqiptare, nuk ofron një sistem qendror transmetimi audioviziv. Madje edhe regjistrimi audio, i ofrohet, çuditërisht, vetëm palëve të interesuara në proces, ndërsa gazetarët nuk lejohen as ta bëjnë atë vetë në sallë. Një kërkesë minimale e cila vetëm sa do të përforconte garancitë për një pasqyrim besnik të deklarimeve të palëve në një proces gjyqësor. Regjistrimi audio i seancave gjyqësore përmes magnetofonit, të cilin çdo gazetar e ka mbajtur gjithmonë me vete, ka qenë një praktikë e zbatuar për vite me radhë nga të gjithë gazetarët shqiptarë, por që çuditërisht tani është ndaluar, bashkë me regjistrimet video.

E drejta e informimit dhe seancat publike, siç parashikohen parimisht dhe në Udhëzimin e KLGJ-së përfaqësojnë një rregull. Për fat të keq eksperiencia e deritanishme, tregon se po trajtohen në një raport të përmbysur, si “përrjashtim nga rregulli”.

Brenda listës së pengesave që rëndojnë çdo ditë punën e gazetarëve në pasqyrimin e seancave gjyqësore, duhet të rendisim edhe ndalimin e të drejtës për të studiuar dosjet gjyqësore, tashmë të disponueshme edhe në formë dixhitale. Ndryshe nga çfarë ndodh në vendet europiane, gazetarët nuk kanë të drejtë as t'i lexojnë dosjet e gjyqeve që trajtohen publikisht gjatë seancave. Të vetmet “letra” që kanë sot në dispozicion gazetarët janë ato që vihen në dispozicion në mënyrë tepër selektive nga njëra prej palëve në gjyq.

Në këtë situatë, kërkojmë ndërhyrjen sa më të shpejtë të KLGJ-ës, që të gjendet një zgjidhje, e cila të mos çenojë të drejtën e informimit. KLGJ mund të ofrojë një interpretim më të detajuar, i cili do t'u lejojte mediave të kryejnë pa pengesa misionin e tyre, duke ngushtuar hapësirat diskrecionale për refuzimin e kërkesave të tyre për të ndjekur seancat gjyqësore dhe për të mundësuar raportimin ndaj opinionit publik me saktësi maksimale, ashtu siç mund të garantohet vetëm përmes regjistrimeve audio dhe video.